

## **Formular për SYLLABUS të Lëndës “Kimia & Biokimia”**

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë Departamenti: Prodhimtaria bimore. Programi: BSC- Prodhimtaria Bimore</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Kimia &amp; Biokimia</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Oblikative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I (parë)</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Asoc. Dr. Imer Haziri</b>
<b>Detajat kontaktuese:</b>	<b>E-mail: imer.haziri@uni-pr.edu</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Kimia dhe Biokimia janë lëndë natyrore eksperimentale. Kursi i këtyre lëndëve është përpiluar në atë mënyrë që të ofrojë një pasqyrë të arsyeshme brenda limitit të caktuar kohor, ( kur dihet se Kimia dhe Biokimia janë një ndër lëmit më të gjëra natyrore). Kohëzgjatja e kursit është në një periudhë 15 javore , i cili përbëhet prej 60 orë ligjërata dhe 30 orë ushtrime . 30 orë ligjërata dhe 15 orë ushtrime janë të parapara për pjesën e Kimisë (për një periudhë 7 javore) dhe 30 orë ligjërata dhe 15 orë ushtrime për pjesën e Biokimisë ( për një periudhë 8 javore) .Sa i përket pjesës së Kimisë ligjëratat fillojnë nga hyrja e Kimisë dhe përfundojnë me pjesën e molekulave të vogla organike, të gjitha shpjegimet teorike njëkohësisht përcjellën edhe nga pjesa e ushtrimeve laboratorike. Pjesa e Biokimisë fillon me Hidratet e Karbonit dhe përfundon me pjesën e metabolizmit të materieve organike, të gjitha të dhënat teorike janë të ndjekura nga ushtrimet laboratorike.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i këtij kursi është që studentëve tu ofrohen njohuri dhe informata lidhur me pjesën e Kimisë së përgjithshme dhe Biokimisë bazale ( nga pikëpamja teorike dhe ajo praktike).
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Të ketë njohuri themelore në pjesën e Kimisë së përgjithshme dhe Biokimisë bazale;</p> <p>Të kenë njohuri lidhur me tretësirat e ndryshme sa i përket përgatitjes dhe përzierjes së tyre ( ku dihet se praktikat dhe punët bujqësore janë mjaft të</p>

	varura nga kjo problematik); Të kenë njohuri dhe aftësi në përdorimin dhe aplikimin e teknikave dhe metodave laboratorike në fushën e Kimisë dhe Biokimisë		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në terren	0	0	0
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	0	0	0
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	0	0	0
Përgaditja përfundimtare për provim	0	0	0
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	0	0	0
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
<b>Totali</b>	<b>11</b>		<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator dhe terren, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokviume, provime.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi pas kollokviumit të parë 25% Vlerësimi pasë kollokviumit të dytë 25% Puna laboratorike 15% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% <b>Total 100%.</b>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	-Mujë Rugova & Tahir Gjegjbitriqi (1998), Kimia, Prishtinë -Sabit Dërmaku (2007): <i>Biokimia, Prishtinë.</i>		
<b>Literatura shtesë:</b>	-Leninger (IVth) Principles of Biochemistry, USA.		
<b>Literatura shtesë:</b>	-Materiale të pregaditura nga profesori i lëndës.		
<b>Plani i dizejnuar i mësimet:</b>			
<b>Ligjëratat</b>			
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>		

<b>Java e parë:</b>	Hyrje. Struktura e materjes. Struktura e atomit. Struktura e molekulave.
<b>Java e dytë:</b>	Formulat kimike. Lidhjet kimike.
<b>Java e tretë:</b>	Reaksionet kimike; nxehtësia, ekuilibri kimik, kinetika e reaksioneve kimike, katalizatorët, reaksionet redoks.
<b>Java e katërt:</b>	Forcat ndër molekulare: gjendjet e materjes, diagramet e fazës, lidhjet hidrogjenore.
<b>Java e pestë:</b>	Tretjet: koncentrimet, tretshmëria. Acidet dhe bazat. Acidet dhe bazat e dobta. Acidet dhe bazat e forta.
<b>Java e gjashtë:</b>	Molekulat e vogla organike: struktura, vetitë, aplikimi, grupet funksionale, izomerët, reaktiviteti.
<b>Java e shtatë:</b>	Vlersimi i pare intermediar dhe seminarët
<b>Java e tetë:</b>	Karbohidratet: Struktura, vetitë, reaktiviteti dhe funksionet në organizëm.
<b>Java e nëntë:</b>	Lipidet: Struktura, vetitë, reaktiviteti dhe funksionet në organizëm. Membranat biologjike.
<b>Java e dhjetë:</b>	Proteinat- Aminoacidet: Struktura, vetitë dhe funksionet në organizëm
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Enzimet: struktura kimike, katalizat funksioni dhe rregullimi i aktivitetit.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Nukleotidet dhe Acidet nukleike: struktura dhe funksioni.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Vitaminat dhe karakteristikat e tyre
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Metabolizm.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Vlerësimi i dytë intermediar dhe seminarët
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Ushtrimet</b>	
<b>Java</b>	
<b>Java e parë:</b>	Formula empirike dhe molekulare. Përbërja në %. Njehsime me reaksionet kimike.
<b>Java e dytë:</b>	Struktura e atomit, numrat kuantike, formula elektronike. Lidhja jonike dhe kovalente Strukturat e Ljuisit.
<b>Java e tretë:</b>	Tretësirat. Përqëndrimet e tretësirave. Vetitë koligative të tretësirave.
<b>Java e katërt:</b>	Ekilibri kimik. Parimi Le Chatelier, Ekuilibrat jonike. PH, Bufferat. Hidroliza.
<b>Java e pestë:</b>	Gazet. Ligjet e gazeve. Stekiometria e gazeve.
<b>Java e gjashtë:</b>	Reaksionet e oksido-reduktimit.
<b>Java e shtatë:</b>	Vlersimi i parë
<b>Java e tetë:</b>	Hyrje në pjesën praktike të Biokimisë
<b>Java e nëntë:</b>	Ushtrime nga pjesa e Hidrateve të Karbonit
<b>Java e dhjetë:</b>	
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Ushtrime nga pjesa e Lipideve
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Ushtrime nga pjesa e Proteinave
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	

<b>ëJava e pesëmbëdhjetë:</b>	Vlersimi i dytë
-------------------------------	-----------------

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkycja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësime janë po ashtu të obligueshme.